

VENDIM
Nr. 559, datë 31.7.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 656, DATË 31.10.2018, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË
SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLAVE, BORDEVE OSE
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 3, të vendimit, numri maksimal i pagesave në një vit, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të kryera, për “Këshillin miratues të projekteve të filmit artistik”, bëhet 6 (gjashtë).

2. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Qendra Kombëtare e Kinematografisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama